



2154

227/8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MEMALIAJ
ZYRA E MJEDISIT
ZYRA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

Nr. 444/1 Prot.Memaliaj, më 07 . 03 2023

Lënda: Kthim përgjigjie dhe dërgim informacioni.

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
TIRANË
Për djeni: QENDRËS "RES PUBLIKA"
TIRANË**

Në përgjigjie të shkresës suaj me nr.206/5 prot. Datë 02.03.2023 me lëndë "Dërgim vendimi", protokolluar nga ana jonë me nr.444 datë 03.03.2023 ku urdhërohet vendosja në dispozicion e informacionit/ dokumentacionit të kërkuar nga "Qendra Res Publika", Ju informojmë si më poshtë:

Mbështetur në pyetjen 1) *A ju është marrë mendim për rishikimin e kufijëve të zonës së mbrojtur para miratimit të VKM-së Nr.59 datë 26.01.2022 "Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore?*

Për sa më sipër Ju bëjmë me dije se Bashkisë Memaliaj nuk i ka ardhur shkresë zyrtare për të shprehur pëlqimin paraprak, në këto kushte nuk ka dhënë mendim.

Referuar pyetjes 2) *Nëse po, kopje të mendimeve/opinioneve të dhëna nga institucioni juaj në lidhje me këtë VKM).*

Bashkia Memaliaj nuk disponon dokumentacion, pasi nuk i është kërkuar zyrtarisht nga institucionet përkatëse, pasi Bashkia Memaliaj është palë e tretë në këtë proces dhe zonat e mbrojtura janë nën administrimin ligjor nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me strukturat përkatëse (AKZM, ADZM).

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Gjolek Guçi

